



10 PRILL 2024

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami mori pjesë në mbledhjen e 17-të Plenare të Rrjetit të Gjykatave Pilot të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), e cila u zhvillua në Mechelen, Belgjikë.

Gjatë takimit, përfaqësues të CEPEJ diskutuan gjerësisht mbi mekanizmat për reduktimin e stokut të çështjeve të pa trajtuara, vlerësimin e cilësisë së punës së gjyqtarëve si dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në sistemet gjyqësore.

Në këtë aktivitet, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Llagami solli praktikën e vendit tonë lidhur me hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të pa trajtuara në gjykata, e cila pritet të zbatohet së shpejti.

Gjatë kësaj seance, pjesëmarrësit patën mundësinë të ndajnë eksperiencat e tyre duke diskutuar rreth sfidave të përbashkëta dhe gjetjes së mekanizmave për të përmirësuar efikasitetin dhe efijencën e të gjithë sistemit gjyqësor.



Kryetarja e Këshillit të Latë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, mori pjesë në mbledhjen e dytë të Bordit Drejtues të Projektit “EU4JUSTICE”, organizuar dhe bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian.

Krahas përfaqësuesve nga institucionet përfituese të projektit, në këtë takim mori pjesë edhe Ambasadori i Bashkimit Evropian në Shqipëri, z. Silvio Gonzato. Në fjalën e tij përshëndetëse, Ambasadori i BE-së mbështeti plotësisht punën e institucioneve të reja të drejtësisë duke theksuar se integrimi në BE varet shumë nga kontributi i tyre. “Drejtësia e dhënë në kohë, në mënyrë efektive dhe transparente është çelësi për rikthimin e besimit të qytetarëve tek institucionet” – ishte mesazhi që përmbylli fjalën e tij.

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami falenderoi projektin për mbështetjen e dhënë përgjatë këtij viti. Ajo theksoi nevojën për një qasje sistematike në adresimin e sfidave të Këshillit në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët dhe partnerët ndërkombëtar.

Në përmblyllje të këtij takimi, të pranishmit diskutuan rreth planit të punës të projektit për periudhën në vijim me qëllim koordinimin e tij me prioritetet e vet institucioneve.



DEKLARATË 28 PRILL 2024

Duke marrë shkas nga informacionet e përcjella nga media e shkruar dhe vizive si edhe bazuar në informacionin paraprak të Policisë, ditën e sotme lidhur me ngjarjen e ndodhur në banesën e magjistratit z. Tonin Sterkaj, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Këshilli i Lartë Gjyqësor përcjell shqetësimin për këto akte që cenojnë rëndë sigurinë e gjyqtarit dhe përbëjnë kërcënim serioz për gjithë shoqërinë shqiptare.

Këshilli i Lartë Gjyqësor dënon aktin kriminal dhe i kërkon organit të akuzës hetimin, zbardhjen e ngjarjes dhe të nxjerrë para përgjegjësisë ligjore personat e përfshirë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor i shpreh mbështetjen të gjithë gjyqtarëve të sistemit gjyqësor për të garantuar sigurinë e tyre, në mënyrë që të ushtrojnë detyrën pa frikën e kërcënimeve, pasi respektimi i funksionit dhe dinjitetit të tyre, është parakusht për një proces të rregullt ligjor, për një sistem drejtësie efektiv dhe efikas, por edhe për funksionimin normal të shtetit të së drejtës.

Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi mori pjesë në vizitën studimore të organizuar nga Universiteti i Floridës së Jugut, në Shën Petersburg, e cila u zhvillua në Tampa-Florida dhe Washington DC, USA, nga data 19.04.2024 deri më 29.04.2024. Në këtë vizitë morën pjesë edhe z. Bezart Kaçkini, zëvendëskryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, z. Paulin Çera, zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe z. Enkel Peza, zëvendëskryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Qëllimi i vizitës ishte marrja e eksperiencës lidhur me qeverisjen e hapur, transparencën dhe llogaridhënien. Me këtë qëllim pjesëmarrësit vizituan Qendrën e Drejtësisë të Kontesë Pinellas, në Clearwater si edhe Gjykatën e Qarkut Tampa – Florida ku zhvilluan takime me gjyqtarë, dhe funksionarë të tjerë të lartë me të cilët u diskutua mbi sistemin gjyqësor amerikan dhe atë shqiptar. Takimet u shoqëruan dhe me pjesëmarrje në procese gjyqësore.

Gjatë kësaj vizite pjesëmarrësit zhvilluan bashkëbisedime me gjyqtarë dhe juristë shqiptarë në SH.B.A, me qëllim ndarjen e eksperiencave të përbashkëta si edhe morën pjesë në trajnimin me temë punën kërkimore të vëzhgimit në sallën e gjyqit “Soaking and Poking” në gjyqësor, mbajtur në Universitetin e Floridës së Jugut, Shën Petersburg me profesoreshë Judithanne Scourfield McLauchlan, ku u realizua dhe një leksion i hapur me studentë shqiptarë dhe ndërkombëtar, me temë “Shteti ligjor dhe shoqëria civile”.

Vizita vijoi me takime me ambasadorin e Republikës së Shqipërisë z. Ervin Bushati dhe atë të Republikës së Kosovës, ku u bisedua mbi sfidat në sistemin e drejtësisë dhe bashkëpunimin e frytshëm me SH.B.A. Po ashtu në Washington D.C u realizua një vizitë në Qendrën Open Gov Hub. Temat kryesore të bashkëbisedimit me drejtorin e kësaj qendre z. Anthony Rodriguez ishin qeverisja, transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve. Pjesëmarrësit morën pjesë në një trajnim me temë mbi qeverisjen e hapur si dhe në aktivitete të tjera të zhvilluara nga kjo qendër. Kjo vizitë studimore u përmbyll me një takim me zyrtarë të Departamentit Amerikan të Shtetit.



10 MAJ 2024

Në datën 10 Maj 2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilluan mbledhjen e përbashkët vjetore në përmbushje të detyrimit ligjor përcaktuar nga neni 170 i Ligjit 115/2016 “ Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Kjo mbledhje, e cila u mbështet nga prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Projekti EU4Justice, u mbajt në Ditën e Drejtësisë, për shkak të simbolikës që përfaqëson kjo datë për sistemin juridik shqiptar.

Të pranishëm në aktivitet ishin z. Bajram Begaj, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Silvio Gonzato, Ambasadori i Bashkimit Evropian, z. David Eisner, i Ngarkuari me Punë i Ambasadës Amerikane, z. Ulsi Manja, Ministri i Drejtësisë,

znj. Clarisse Pasztory, Kryetare në Detyrë e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, anëtarët e të dy këshillave, përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet kushtetuese të Republikës, përfaqësues të trupës gjyqësore dhe të prokurorisë, si dhe partnerë ndërkombëtar.

Mbledhja u hap më fjalën përshëndetëse të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Llagami, e cila theksoi se kjo është një ditë reflektimi. Organizimi i takimeve në një ditë si kjo, që kremton përpjekjet tonë të përbashkëta tek drejtësia që kemi dhe ajo që duam, tashmë është kthyer një traditë për Këshillin.

Znj. Llagami nënvizoi se llogaridhënia dhe përgjegjshmëria janë dy shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës, të cilat nuk janë në kundërshtim me njëra tjetrën, përkundrazi, gur themeli për një drejtësi që i përgjigjet pritshmërive të publikut.

Gjatë tryezës së rrumbullakët që u mbajt në kuadër të këtij aktiviteti, z. Ridvan Hado, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, njëkohësisht Kryetar i Komisionit Disiplinor prezantoi draft rregulloren për bashkimin e procedimeve disiplinore në rastet kur një gjyqtar dhe një prokuror janë të përfshirë në të njëjtën shkelje. Rregullore kjo e cila është rezultat i bashkëpunimit të suksesshëm mes dy Këshillave, me kontributin e rëndësishëm të ekspertëve ndërkombëtar.

Në përfundim të këtij aktiviteti, pjesëmarrësit diskutuan mbi aspektet praktike të zbatimit të përbashkët të kësaj rregulloreje si dhe mbi çështje të tjera me interes të përbashkët.



20 MAJ 2024

Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi Takimin e Nivelit të Lartë me temë “Prezantimi i Strategjisë Kombëtare të Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata (2024-2027)”. Ky takim u organizua në bashkëpunim me Projektin “Ulja e numrit të çështjeve të prapambetura dhe përmirësimi i efikasitetit në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë”, zbatuar nga Instituti i Menaxhimit Lindje – Perëndim (EWMII), me mbështetjen e Byrosë për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Ligjzbatimit, Departamenti Amerikan i Shtetit (INL).

Të pranishëm ishin znj. Naureda Llagami, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. David Wisner, i Ngarkuari me Punë i Ambasadës së SH.B.A, znj. Giulia Re, Drejtuese e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, z. Ulsi Manja, Ministri i Drejtësisë, si dhe znj. Klotilda Bushka, Kryetare e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të

Drejtat e Njeriut, të cilët shprehën njëzëri mbështetjen për miratimin e strategjisë dhe zbatimin me efikasitet të saj, me qëllim dhënien e rezultateve të pritshme për publikun.

Në fjalën e saj, znj. Naureda Llagami, u shpreh se në vazhden e iniciativave konkrete, sot KLGJ-ja vjen me një produkt, i cili adreson për herë të parë, në mënyrë strategjike, multi-dimensionale dhe tërësore një problematike që prek thelbin e shtetit ligjor dhe të drejtave të njeriut. Për këtë arsye, znj. Llagami, i bëri thirrje për bashkëpunim çdo gjyqtari por edhe të gjitha pushteteve, Qeverisë dhe Kuvendit, për t'i dhënë sistemit atë që i premtuam popullit me reformën në drejtësi, jo vetëm besimin dhe pavarësinë por edhe mbështetjen buxhetore, infrastrukturore dhe ligjore.

Në pjesën e dytë të takimit, z. Ilir Rusi, Zëvendëskryetari i KLGJ-së dhe njëkohësisht Kryetari i Grupit të Punës për hartimin e strategjisë, së bashku me z. Ardian Dvorani, Zëvendëskryetari i Gjykatës Administrative të Apelit dhe anëtar i Grupit të Punës, prezantuan në mënyrë më të hollësishme setin e masave për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe parandalimin e krijimit të tyre në të ardhmen.

Takimi u mbyll me një sesion diskutimesh, ku pjesëmarrësit ndanë mendimet e tyre mbi sfidat për zbatimin praktik të Strategjisë Kombëtare të Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata 2024-2027.



31 MAJ 2024

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Naureda Llagami, në funksionin e Kryetares së Bordit të QTI-së, bashkëkryesoi me Ambasadorin e Delegacionit të Bashkimit Europian z. Silvio Gozato, takimin strategjik mbi krijimin e Sistemit të Ri të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve (ICMIS) për Sistemin e Drejtësisë.

Në këtë takim ishin prezent Ambasadori i Ambasadës Suedeze z. Niklas Strom, përfaqësuesja e UNOPS-it në Shqipëri si dhe përfaqësues të institucioneve më të larta të sistemit të drejtësisë në vend.

Qëllimi i këtij takimi ishte nxitja e progresit të mëtejshëm dhe unifikimi i përpjekjeve për krijimin e Sistemit të Ri të Menaxhimit të Çështjeve për Sistemin e Drejtësisë, i cili do të mundësojë rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore për qytetarët. Ndër të tjera, diskutimet u fokusuan tek korniza e ndërveprimit të bazës së të dhënave mes ICMIS-it të ri dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit të institucioneve apo agjensive të tjera në vend, për të garantuar shkëmbimin e sigurt dhe me efikasitet të informacionit.

Në përfundim të takimit, palët dakordësuan për të vijuar me prioritet punën për krijimin dhe vënien në funksion të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve për Sistemin e Drejtësisë.



5 QERSHOR 2024

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësore, Znj. Llagami, së bashku me një grup gjyqtarësh të seksionit penal nga gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm pritën në një takim pune Ambasadorin Britanik, Sh.T. Z. Alastair King-Smith.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi Marrëveshjen e ratifikuar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut mbi transferimin e personave të dënuar, me fokus identifikimin e sfidave dhe vështirësitë që gjyqtarët kanë hasur gjatë zbatimit praktik të kësaj marrëveshjeje.

Ky takim punë vjen në vazhden e një serie takimesh informuese dhe ndërgjegjësuese që Këshilli së bashku me Ambasadën Britanike në Tiranë kanë zhvilluar. Takime këto të cilat kanë shërbyer si forume diskutimesh në funksion të shkëmbimit të eksperiencave midis gjyqtarëve shqiptar edhe atyre britanik për të mundësuar zbatimin sa më të mirë të kësaj marrëveshjeje.



Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me prezencën e organizatës për siguri dhe bashkëpunim me Europën (OSBE), zhvilloi trajnimin e radhës për gjyqtarët e medias.

Në këtë trajnim ishin të pranishëm nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, z. Mauro Puzzo, drejtues i Departamentit Ligjor dhe të Drejtave të Njeriut pranë OSBE, gjyqtarë të caktuar për median nga të gjitha nivelet, si dhe përfaqësues të medias.

Trajnimi dy ditor ndërthuri njohuritë teorike me teknika praktike të ndërveprimit efektiv të gjyqtarëve me median dhe publikun, si dhe ju dha mundësi gjyqtarëve të medias të ndajnë eksperiencat konkrete nga puna e tyre. Këshilli i Lartë Gjyqësor me krijimin e tij, mbetet i angazhuar për një komunikim efikas dhe cilësor me median dhe publikun, në administrim të një gjyqësori që meriton besimin e publikut.



MASAT E MARRA PËR FUNKSIONALITETIN E SISTEMIT GJYQËSOR

- Në kuadër të procesit të vlerësimit etik profesional të gjyqtarëve si dhe atij të ngritjes në detyrë, Këshilli gjatë 3 muajve të vitit 2024 vendosi miratimin e raporteve të vlerësimit etik dhe profesional, për **8 gjyqtarë për periudhën e vlerësimit 2013-2016**, për **2 gjyqtarë për periudhën 2017-2019** dhe për **3 gjyqtarë për vitin 2022**.
- Në vijim të procesit për vlerësimin e punës së gjyqtarëve, Këshilli vendosi miratimin e raportit të vlerësimit etik dhe profesional për **1 gjyqtarë të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për periudhën e vlerësimit 10.02.2020-21.11.2022**.
- Këshilli vendosi fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit. Gjithashtu, Këshilli vendosi për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2024.

- Pas procedurave të shorteve, Këshilli vendosi për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit **viti kalendarik 2023 për 1 gjyqtare**; për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit **viti kalendarik 2022 për 10 gjyqtarë**; për periudhën e vlerësimit **2017-2021 për 1 gjyqtare** si dhe për periudhën e vlerësimit **viti kalendarik 2019 për 1 gjyqtar**.
- Pas procedurës së shortit, Këshilli miratoi vendimin për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, **për 1 gjyqtare** të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, **për periudhën e vlerësimit 02.03.2020 – 14.06.2023**.
- Këshilli miratoi vendimet për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, **në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtarëve z. Ardit Mustafaj dhe z. Bib Ndreca**.
- Këshilli vendosi për transferimin e gjyqtarëve znj. **Suela Lika dhe z. Ardit Kuka në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan** si dhe transferimin e gjyqtarit **z. Besmir Stroka në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë**.
- Këshilli vendosi për transferimin e përkohshëm të gjyqtarës znj. **Suela Dashi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës**.
- Këshilli miratoi vendimin për **komandimin e znj. Olta Cenaj si “ndihmësmagjistrate”, në Gjykatën e Lartë**.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi vendimin për **pranimin në shërbimin civil gjyqësor të z. Aurel Celibashi, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor** pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Këshilli miratoi vendimet për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele për **2 pozicione të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan; 4 pozicione të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; 3 pozicione të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; 1 pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier** si dhe **2 pozicione të lira në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë**.
- Gjithashtu, Këshilli vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit **në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për 3 pozicione të lira**.
- Këshilli vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë **në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 pozicion të lirë**.
- Në përputhje me dispozitat ligjore, Këshilli vendosi hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm **për 1 pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës**.
- Këshilli vendosi për **fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024 si dhe **në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm** për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Këshilli vendosi **për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë**, të shpallura me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, **për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim**.
- Këshilli vendosi për **fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë**, të shpallura me vendimet nr. 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 242, 243, datë 02.05.2024 dhe nr. 260, datë 16.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi vendimet përkatëse për **renditjen e kandidatëve në procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë**, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, 257 dhe 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

- Këshilli vendosi **kualifikimin e 8 kandidatëve dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë**, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 73, nr. 74, nr. 75, nr. 76, nr. 77, nr. 78, nr. 79, nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor **kualifikimin e 9 kandidatëve dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës**, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 82, nr. 83, nr. 84, nr. 85 dhe nr. 86, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Gjithashtu, pas procedurës të shortit, Këshilli miratoi vendimin për fillimin e procedurave të **përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan, Durrës dhe Tiranë** për pozicionet e shpallura të lira, përkatësisht me vendimet nr. 249, datë 24.05.2023; nr. 22, nr. 23, datë 18.01.2023 dhe nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85 dhe 86, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Gjithashtu, Këshilli vendosi **verifikimin e plotësisimit për 4 kandidatë të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm** dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, si më poshtë:
 - për 1 kandidate për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 246, datë 24.05.2023;
 - për 1 kandidate për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 245, datë 24.05.2023;
 - për 1 kandidate për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244, datë 24.05.2023;
 - për 1 kandidat për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 240 datë 24.05.2023.
- Këshilli miratoi vendimin për **fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025.**
- Në përmbushje të detyrimit ligjor, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e **“Raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2023”.**
- Këshilli miratoi aktin e rëndësishëm të **“Strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”.**
- Këshilli vendosi miratimin e **“Rregullores për formimin profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë”** si dhe miratimin e **“Planit Strategjik 2024-2025 për trajnimin fillestar dhe vazhdues të nëpunësve civilë gjyqësorë”.**
- Këshilli vendosi miratimin e rregullores **“Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”, duke miratuar kështu kuadrin e plotë rregullator për administrimin dhe mirë-funksionimin e burimeve njerëzore në gjykata.**
- Këshilli vendosi mbi **përcaktimin e tarifave për trajnerë/ekspertë e lehtësues**, që do të ofrojnë programin e formimit fillestar dhe vazhdues për nëpunësit civil gjyqësor.
- Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor caktoi znj. **Mevlute Çausi, gjyqtare për median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe z. Orgent Nazaj, gjyqtar për median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.**

DISIPLINA DHE TRANSPARENCA



Me qëllim ruajtjen e integritetit gjyqësor, gjatë kësaj periudhe, Komisioni Disiplinor ka vijuar punën lidhur me shqyrtimin e kërkesave për fillimin e procedimeve disiplinore ardhur nga ILD gjatë vitit 2024 si dhe në vijim të procedurave **Këshilli ka proceduar me dhënien e 4 vendimeve** lidhur me to, Konkretisht:

- **Me vendimin nr. 180, datë 09.04.2024** është vendosur shkarkimi nga detyra e magistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}.


- **Me vendimin nr. 181, datë 09.04.2024** është vendosur pezullimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj magistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...} deri në marrjen e formës së prerë të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- **Me vendimin nr. 208 datë 18.04.2024** është vendosur rrëzimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për masën disiplinore shkarkim nga detyra në ngarkim të magistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}.
- **Me vendimin nr. 268, dt. 29.05.2024** është vendosur shkarkimi nga detyra e magistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}.

Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor **trajtoi 12 kërkesa për caktimin e 16 gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e çështjeve** gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

KLJGJ, në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, gjatë kësaj periudhe, ka trajtuar **19 kërkesa** për informacion, të ardhura si përmes postës elektronike ashtu edhe në rrugë zyrtare, të cilat morën përgjigje brenda një afati të arsyeshëm.

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun me Jashtë dhe Botimet ka trajtuar **164 shkresa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë, organizata dhe institucione publike dhe jopublike.

Veprimtaria e KLGJ-së (prill-qershor 2024):



- 17 mbledhje plenare
- 155 akte të miratura në ndihmë të të gjithë sistemit gjyqësor, më konkretisht:
 - 14 akte kolektive, Prill 2024
 - 27 akte kolektive, Maj 2024
 - 10 akte kolektive, Qershor 2024
 - 49 akte individuale, Prill 2024
 - 22 akte individuale, Maj 2024
 - 15 akte individuale, Qershor 2024

Pjesa tjetër përfshihen rregulla të brendshme, aktet e miratimit të procesverbaleve të mbledhjes plenare dhe hartimin e aktit nënligjor me karakter normative si dhe udhëzime.



KLJGJ FACEBOOK

Ndjekës në total

2978

-na ndiqni-

Adresa: Godina “Poli i Drejtësisë”, Rruga “Ana Komnena”, Tiranë

www.klgj.al

e-mail: kontakt@klgj.al